



**REPUBLIKAE SHQIPËRISË  
KUVENDI**

**PROJEKT LIGJ**

Nr. \_\_\_\_\_/2026

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.25/2024  
PËR SIGURINË KIBERNETIKE**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**K U V E N D I**

**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**V E N D O S I:**

Në ligjin nr. 25/2024 “Për sigurinë kibernetike” bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

**Neni 1**

Në nenin 5 bëhen ndryshime dhe shtesa si më poshtë:

1. Pika 5 ndryshohet si më poshtë:

“5. “CSIRT sektorial” është ekipi i përgjigjes ndaj incidenteve të sigurisë kibernetike për sektorin përkatës, sipas përcaktimeve në anekset e këtij ligji, i ngritur nga Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike, institucioni përgjegjës për licencimin dhe mbikëqyrjen e bankave dhe operatori qeveritar që menaxhon infrastruktura qeveritare dhe funksionon pranë ministrive përgjegjëse, institucionit rregullator për bankat, Autoritetit apo operatorit qeveritar që menaxhon infrastrukturat qeveritare.”

2. Pas pikës 58 shtohet pika 59 dhe 60 me këtë përmbajtje:

“ 59. Organi i blerjes së përqendruar për trajnimet në fushën e sigurisë kibernetike” është autoriteti publik, i cili organizon, kryen prokurimet e qendëruara për trajnimet në fushën e sigurisë kibernetike, për operatorët e infrastrukturave të informacionit të administratës shtetërore, sipas përcaktimeve të këtij ligji dhe legjislacionit të posaçëm.

60. Vetëdeklarimi i masave të sigurisë kibernetike është një instrument paraprak vlerësimi dhe monitorimi, me qëllim evidentimin e gjendjes aktuale të përputhshmërisë, identifikimin e mangësive që duhet të ndërmerren nga operatori i infrastrukturës kritike dhe të rëndësishme të informacionit.”.

## **Neni 2**

Në nenin 9 bëhen ndryshime dhe shtesa si më poshtë:

1. Në shkronjën “c” fjalët “dhe CERT-it” shfuqizohet.
2. Në shkronjën “h” në fillim të fjalisë shtohet togëfjalëshi “mbron qytetarët dhe grupet vulnerabël,”;
3. Pas shkronjës “j” shtohet shkronjat “k” , “l” dhe “ll” me këtë përmbajtje:  
“k) organizon, kryen prokurimet e përqendruara për trajnimet në fushën e sigurisë kibernetike, me vlerë mbi kufirin monetar të prokurimeve me vlera të vogla për operatorët e infrastrukturave të informacionit të administratës shtetërore në përputhje me legjislacionin në fuqi të prokurimeve” të cilat jo më vonë se data 30 prill i dërgojnë kërkesë me shkrim pranë AKSK- së për nevojat e tyre për trajnime, sipas buxhetit të miratuar;  
l) autorizon organet e vlerësimit të konformitetit sipas skemës kombëtare të certifikimit të sigurisë kibernetike, të akredituara nga institucioni përgjegjës për akreditimin, duke specifikuar kategoritë e produkteve TIK dhe profilet e mbrojtjes në të cilat shtrihet autorizimi.  
ll) kryen procedurat e prokurimit publik për pajisjet, programet, licencat, platformat dhe sistemet e sigurisë kibernetike në funksion të Autoritetit”.

## **Neni 3**

Në neni 12 bëhen ndryshime dhe shtesa si më poshtë:

1. Në fjalinë e parë të pikës 4 pas fjalëve “kanë detyrimin të” shtohet togëfjalëshi “japin informacion dhe të”.
2. Pika 5 ndryshon me këtë përmbajtje:  
“5. Lista e operatorëve të infrastrukturave kritike dhe të rëndësishme të informacionit miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave dhe përditësohet të paktën një herë në dy vjet.”.

## **Neni 4**

Në nenin 13 bëhen ndryshime dhe shtesa si më poshtë:

1. Në shkronjën “g”, pas fjalës “vulnerabiliteteve” shtohen fjalët “të shfrytëzueshme”.
2. Shkronja “ll” ndryshohet me këtë përmbajtje:  
“ll. Kryen simulime në rrjetet dhe sistemet e infrastrukturave kritike dhe të rëndësishme të informacionit, duke shfrytëzuar vulnerabilitetet e evidentuara nëpërmjet skanimeve proaktive sipas

shkronjës “g” të këtij neni, duke njoftuar paraprakisht operatorët. Procedura e simulimit miratohet me urdhër të drejtorit të përgjithshëm të Autoritetit;”.

3. Shkronja “nj” ndryshohet me këtë përmbajtje:

“nj. Koordinon me Policinë e Shtetit dhe çdo institucion përgjegjës për të mundësuar mbledhjen dhe ruajtjen e provave si dhe hetimin teknik të incidentit kibernetik, kur dyshon për elementë të krimit kibernetik, apo veprave të tjera penale të lidhura me to në infrastrukturën e informacionit, në rastet e kërkuara nga institucionet ligjzbatuese, duke gëzuar dhe atributet e Policisë Gjyqësore, në përputhje me Kodin e Procedurës Penale dhe ligjin për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore;”.

## **Neni 5**

Pika 1 e nenit 15 ndryshon si më poshtë:

“1. Autoritetit Kombëtar për Sigurinë Kibernetike, institucioni përgjegjës për licencimin dhe mbikëqyrjen e bankave dhe operatori qeveritar që menaxhon infrastruktura qeveritare, ngrenë në strukturën e tyre CSIRT-et sektoriale përgjegjës për incidentet e sigurisë kibernetike.”.

## **Neni 6**

Shkronja “dh” e nenit 16 riformulohet si vijon:

“dh) njofton CSIRT-in Kombëtar dhe atë pranë operatorit menjëherë pasi identifikon incidentin, si dhe njofton CSIRT-in Kombëtar në rast të zgjidhjes së shpejtë të incidentit të ndodhur në infrastrukturën që administrojnë;”.

## **Neni 7**

Në pikën 3 të nenit 17 bëhen shtesa dhe ndryshime si më poshtë:

1. Shkronja “ë” riformulohet si vijon:

“ë) raporton pranë CSIRT-it Kombëtar dhe CSIRT-it sektorial çdo incident të sigurisë kibernetike të ndodhur në infrastrukturën e tyre dhe bashkëpunon me këto struktura për shkëmbimin e informacionit, koordinimin e veprimeve dhe zbatimin e masave të nevojshme për parandalimin, reagimin dhe rikuperimin nga incidentet e sigurisë kibernetike;”.

2. Pas shkronjës “f” të pikës 3, shtohet shkronja “g” me këtë përmbajtje:

“g) zbatojnë masat për bllokimin, filtrimin, kufizimin, detektimin ose neutralizimin e treguesve të komprometimit (IOC), treguesve të sulmeve (IOA) dhe vulnerabiliteteve të komunikuar nga Autoriteti, në rrjetet, sistemet, platformat, pajisjet, aplikacionet dhe shërbimet TIK që administrohen prej tyre, me qëllim mbrojtjen e infrastrukturave të tyre nga kërcënimet ose incidentet e sigurisë kibernetike.”.

## **Neni 8**

Në nenin 20 pas pikës 6 shtohet pika 7 me këtë përmbajtje:

“7. Procedurat dhe kriteret për regjistrimin e organeve të vlerësimit të konformitetit për vlerësimin e masave të sigurisë kibernetike, përcaktohen me udhëzimin e drejtorit të përgjithshëm të Autoritetit.”

## **Neni 9**

Pas nenit 20 shtohet neni 20/1 dhe 20/2 me këtë përmbajtje:

### **“Neni 20/1**

#### **Vetëdeklarimi i masave të sigurisë kibernetike**

1. Operatorët e infrastrukturave kritike dhe të rëndësishme të informacionit kanë detyrimin të dorëzojnë pranë Autoritetit vetëdeklarimin e zbatimit të masave teknike, organizative dhe operacionale të sigurisë kibernetike, në përputhje me kërkesat e këtij ligji dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.
2. Informacioni i paraqitur në vetëdeklarim duhet të jetë i saktë, i plotë dhe i përditësuar.
3. Forma, përmbajtja, mënyra e paraqitjes, afatet dhe procedurat për administrimin e procesit të vetëdeklarimit përcaktohen me urdhër të drejtorit të përgjithshëm të Autoriteti.

### **Neni 20/2**

#### **Vetëdeklarimi i hostimit dhe administrimit të sistemeve, rrjeteve dhe infrastrukturës së informacionit**

1. Operatorët e infrastrukturave kritike dhe të rëndësishme të informacionit kanë detyrimin të deklarojnë pranë Autoriteti mënyrën e hostimit dhe administrimit të sistemeve, rrjeteve dhe infrastrukturës së informacionit, duke përfshirë:
  - a) identifikimin e subjektit hostues ose administratorit të infrastrukturës teknologjike;
  - b) llojin e hostimit dhe vendndodhjen e infrastrukturës;
  - c) masat teknike dhe organizative të zbatuara për sistemet e hostuara;
  - d) përdorimin e shërbimeve cloud, virtualizimit.
2. Mënyra, forma, përmbajtja dhe procedurat e vetëdeklarimit përcaktohen me urdhër të drejtorit të përgjithshëm të Autoriteti.”

## **Neni 10**

Në pikën 4 të nenit 29 pas fjalëve “dhe funksionimit të CERT-it” shtohet togëfjalëshi “..., si dhe shpërblimi i ekspertëve të angazhuar në CERT”.

## **Neni 11**

Pas nenit 33 shtohet neni 33/1, “Grupi ndëristitucional i Inteligjencës Kibernetike”, me këtë përmbajtje:

### **“Neni 33/1 Grupi ndëristitucional i Inteligjencës Kibernetike**

1. Pranë Autoritetit ngrihet Grupi ndëristitucional i Inteligjencës Kibernetike me përfaqësues të institucioneve si më poshtë:
  - a) Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike;
  - b) Ministria përgjegjëse për punët e jashtme;
  - c) Ministria përgjegjëse për punët e brendëshme;
  - ç) Shërbimi Informativ i Shtetit;
  - d) Shtabi i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura;
  - dh) Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes.
2. Grupi ndëristitucional i Inteligjencës Kibernetike sipas përcaktimeve të pikës 1 të këtij neni kryesohet nga Autoriteti dhe ushtron detyrat si më poshtë:
  - a) shkëmbimin e informacionit paralajmërues lidhur me tregues potencialë të kërcënimeve kibernetike;
  - b) vlerësimin e ndikimit potencial të kërcënimeve kibernetike ndaj sigurisë kombëtare, ekonomisë dhe shërbimeve publike;
  - c) ofrimin e rekomandimeve për përmirësimin e strategjive si dhe politikave kombëtare në fushën e sigurisë kibernetike;
  - ç) hartimin e buletineve periodike të kërcënimeve kibernetike.
3. Mënyra e organizimit dhe funksionimin të Grupit ndëristitucional të Inteligjencës Kibernetike përcaktohet me urdhër të Kryeministrit.”.

## **Neni 12**

Në pikën 5 të nenit 39 fjalët “të akredituara” zëvendësohet me togëfjalëshin “të autorizuara nga autoriteti përgjegjës”.

## **Neni 13**

Në nenin 41 bëhen shtesa dhe ndryshime si më poshtë:

1. Pika 1 ndryshon si më poshtë:

“1. Autoriteti inkurajon operatorët e infrastrukturave kritike dhe të rëndësishme të informacionit të përdorin produkte, shërbime dhe procese TIK, të zhvilluara nga operatori i infrastrukturës kritike dhe të rëndësishme të informacionit ose të siguruara nga palë të treta, të certifikuar sipas skemës kombëtare të certifikimit të sigurisë kibernetike ose një skemë evropiane të certifikimit të sigurisë kibernetike.”

2. Shtohet pika 3 me këtë përmbajtje:

“3. Lista e operatorëve të infrastrukturave kritike dhe të rëndësishme të informacionit që duhet të përdorin produkte, shërbime dhe procese TIK të certifikuar, ose të marrin një certifikatë të sigurisë kibernetike për produktet, shërbimet dhe proceset TIK, sipas skemës kombëtare të certifikimit të sigurisë kibernetike ose një skeme evropiane të certifikimit të sigurisë kibernetike, bazuar në një vlerësim të ndikimit për secilin operator dhe në konsultimet e realizuara me, miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave. Lista hartohet në rastet kur identifikohen nivele të pamjaftueshme të sigurisë kibernetike dhe përfshin periudhën e zbatimit`.”.

#### **Neni 14**

Pika 2 e nenit 42 ndryshohet si më poshtë:

“2. Procedura dhe kriteret për autorizimin e organeve të vlerësimit të konformitetit sipas skemës kombëtare të certifikimit të sigurisë kibernetike përcaktohen me Vendim të Këshillit të Ministrave.”.

#### **Neni 15**

Në nenin 44 bëhen shtesa dhe ndryshime si më poshtë:

1. Shkronja “b” ndryshon si më poshtë:

“b) mosdhënia e informacionit dhe mosraportimi i saktë i infrastrukturave të informacionit gjatë procesit të identifikimit, sipas përcaktimeve të pikës 4 të nenit 12 të këtij ligji dhe akteve nënligjore në zbatim të tij;”.

2. Pas shkronjës “ë” shtohen shkronjat “f”, “g”, “gj” dhe “h” me këtë përmbajtje:

“f) mosdorëzimi brenda afatit të vetëdeklarimit të masave të sigurisë kibernetike, sipas përcaktimeve të pikës 1, të nenit 20/1 të këtij ligji;

g) mosparaqitja e të dhënave të sakta, të plota dhe të përditësuara në vetëdeklarim, sipas përcaktimeve të pikës 2, të nenit 20/1 të këtij ligji;

gj) mosdeklarimi pranë Autoritetit për mënyrën e hostimit dhe administrimit të sistemeve, rrjeteve dhe infrastrukturës së informacionit sipas përcaktimeve të pikës 1, të nenit 20/2 të këtij ligji;

h) moszbatimi masave për bllokimin, filtrimin, kufizimin, detektimin ose neutralizimin e treguesve të komprometimit (IOC), treguesve të sulmeve (IOA) dhe vulnerabiliteteve të komunikuar nga Autoriteti sipas përcaktimeve të shkronjës “g”, të pikës 3, të nenit 17, të këtij ligji.”.

#### **Neni 16**

Pika 1 e nenit 45 ndryshohet si më poshtë:

“1. Kur Autoriteti konstaton shkeljen e dispozitave, të cilat përbëjnë kundërvajtje administrative, sipas nenit 44 të këtij ligji vendos dënimin me gjobë si më poshtë:

- “a) nga 1 000 000 deri në 10 000 000 lekë në rast të shkeljeve administrative të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “d” të nenit 44 të këtij ligji;
- b) nga 2 000 000 deri në 4 000 000 lekë në rast të shkeljeve administrative të përcaktuara në shkronjat “b”, “c”, “ç”, “e” të nenit 44 të këtij ligji ;
- c) nga 4 000 000 deri në 10 000 000 lekë në rast të shkeljeve administrative të përcaktuara në shkronjën “dh”, “h” të nenit 44 të këtij ligji;
- ç) nga 2 000 000 lekë deri në 5 000 000 lekë në rast të shkeljeve administrative të përcaktuara në shkronjën “ë” të nenit 44 të këtij ligji;
- d) 5 000 000 lekë në rast të shkeljeve administrative të përcaktuara në shkronjën “f” të nenit 44 të këtij ligji;
- dh) 3 000 000 lekë në rast të shkeljeve administrative të përcaktuara në shkronjën “g” “gj” të nenit 44 të këtij ligji.”.

### **Neni 17**

Në Aneksin I të ligjit “Sektorë me kritikalitet të lartë”, në sektorin Administrata Publike në nënndarjen “Llojin e subjektit” shtohet “Subjektet e administratës publike të vetëqeverisjes vendore”.

### **Neni 18**

#### **Aktet nënligjore**

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që brenda 12 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji të nxjerrë aktin nënligjor në zbatim të nenit 41, pika 3.
2. Ngarkohet kryeministri që brenda 12 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji të nxjerrë aktin nënligjor në zbatim të nenit 33/1, pika 3.
2. Ngarkohet drejtori i përgjithshëm i Autoritetit që brenda 12 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 13, shkronja “ll”, 20, pika 7, 20/1, pika 3, 20/2, pika 2.

### **Neni 19**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.